



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK-ja (në tekstin e mëtejshëm) në seancën së 87-të, të mbajtur më 01.06.2023, morri vendimin vijues:

VENDIM

Veprimi sipas denoncimit me numër 12-665/1 të datës 02.02.2023, **NDËRPRITET.**

KSHPK-ja vërtetoi se lënda nuk ka elemente për veprim të mëtejshëm.

Lënda me numër 12-665 të vitit 2023 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 12-665/1 datë 02.02.2023 është formuar në bazë të kërkesës së dorëzuar nga ///. Pretendimet e paraqitura i referohen dyshimeve për punë të pakujdesshme nga personat zyrtar të drejtorisë rajonale të ///, si dhe në lidhje me mosdorëzimin e dokumenteve pas ankesës së parashtruesit për një çështje për të cilën është marrë vendim në shkallë të parë nga autoriteti i përmendur më parë. Konkretisht, bëhet fjalë për një ankesë në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurën Administrative dhe në Procedurën e Punësimit në shkallë të dytë, ndërsa autoriteti i lartpërmendur nuk i ka dorëzuar dosjet për këtë çështje për qëllime të veprim tek autoriteti kompetent i shkallës së dytë. KSHPK-së i kërkohet shqyrtimi i çështjes në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Krahas denoncimit është dorëzuar edhe një dëshmi.

Pas këqyrjes së përmbajtjes së kërkesës dhe provave të paraqitura, KSHPK-ja kërkoi veprime kompetente nga Inspektorati Administrativ Shtetëror i RMV-së dhe nga autoriteti i lartpërmendur i shkallës së parë, dhe nga këqyrja e provave të paraqitura doli se pretendimet përsëriten, prandaj janë ndërmarrë veprime specifike dhe masa inspektuese nga Inspektorati Administrativ Shtetëror dhe masa. Duke vepruar sipas këtyre veprimeve, autoriteti i shkallës së parë ka njoftuar KSHPK-në se lënda me të gjitha dokumentet i është dorëzuar autoritetit kompetent të shkallës së dytë për veprime të mëtejshme dhe kjo me rastin e ankesës së deklaruar nga parashtruesi, nga i cili rezultoi se çështja nuk ka elemente për veprime të mëtejshme.

Адреса: ул. Пресвета Богородица број 3, 1000 Скопје - Република Северна Македонија

Adresa: rr. Presveta Bogorodica nr.3, 1000 Shkup - Republika e Maqedonisë së Veriut

email: contact@dksk.org.mk

тел/tel: +389 2 3248 930

<https://www.dksk.mk>

Sipas sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv.

Dorëzuar:
- Parashtruesi.

Përgatiti: Mr. D.D
Miratoi: Mr. SH.S

**KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
NËNKRYETAR,
Katica Nikolovska**

